



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1318/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Swiss Diamond Hotel shpk me numër identifikues 810518417 me seli në Prishtinë, kundër debitorit Ministria e Arsimit dhe Shkencës me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP.nr.582/2022 të datës 28.07.2023, me datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit Ministria e Arsimit dhe Shkencës me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP.nr.582/2022 i datës 28.07.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.582/2022 të datës 28.07.2023, ka Refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit Ministria e Arsimit dhe Shkencës me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.240/20 të datës 26.10.2020, të përmbartuesit privat Rrezaarta Metaj, dhe ka lënë në fuqi Urdhrin përmbartimor P.nr.240/2020 të datës 26.10.2020 të lejuar nga përmbartuesi privat Rrezarta Metaj.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ankesë ka paraqitur përfaqësuesja e debitorit, duke e kontestuar në tërësi si të pabazuar urdhërin për lejimin e përmbartimit të propozuar, me arsyetimin se dokumenti përmbartimor nuk është i përshtatshëm për përmbartim pasi që fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i përmbartueshëm, pasi që e njëjta nuk është pranuar nga debitori, andaj nuk është i përshtatshëm për përmbartim, i propozon gjykatës që të aprovohet ankesa, deh të shfuqizohet urdhri përmbartimor.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Swiss Diamond Hotel shpk me numër identifikues 810518417 me seli në Prishtinë, me datë 23.10.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit Ministria e Arsimit dhe Shkencës me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm - faturës nr.11196536 të datës 12.05.2019, për shumën prej 1.603.50 €.

Përmbartuesi privat Rrezarta Metaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.240/2020 të datës 26.10.2020, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës, duke obliguar debitorin që kreditorit t,ia paguajë shumën prej 1,603.50€ me kamatë prej 8% nga dita kur borxhi është bërë i arritshëm për pagesë, e deri në pagesën përfundimtare.

Kundër këtij urdhri përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i përmbartueshëm, pasi që e njëjta nuk është pranuar nga debitori dhe nuk është nënshkruar apo vulosur, i propozon gjykatës që të aprovohet prapësimi dhe të anulohet urdhri për përmbartim.

Në përgjigje në prapësim kreditori thekson se prapësimi i debitorit nuk gjen mbështetje në nenin 71 të LPP-së. Në faturë janë treguar marrësi i shërbimit dhe ofruesi i shërbimit, lloji i shërbimit, lartësia e detyrimit s dhe koha e përmbushjes së detyrimit financiar, dhe rrjedhimisht fatura i përmbart të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 39 të LPP-së, Fatura i është dorëzuar debitorit përmes e-mail zyrtar ndërsa debitori me datën 16.05.2019 me e-mail ka konfirmuar pranimin e e-mailit dhe të faturës dhe se ka premtuar se do ta përmbush pagesën sipas faturës, mirëpo në fakt vetëm se e ka shtyre pagesën, propozon gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.582/2022 të datës 28.07.2023, ka Refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, Dhoma e shkallës së parë, ka theksuar se duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së. Tutje

gjkata ka arsyetuar se debitori me e-mail dt.16.05.2019 ka konfirmuar pranimin e e-mail me përmbajtje të faturës pa e kundërshtuar të njëjtën, dhe rrjedhimisht debitori ka qenë i njoftuar me detyrimin që buron nga fatura dhe është pajtuar me përmbajtjen e saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaremore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturës nr.11196536 datës 12.05.2019, për shumën e detyrimit prej 1,603.50 €, të lëshuar nga kreditori, e cila rezulton se është pranuar dhe konfirmuar nga debitori përmes email- zyrtar datës 16.05.2019, e cila mënyrë e komunikimit konsiderohet e rregullt. Kjo fatur e ka cilësinë e dokumentit të besueshëm konform nenit 29 paragrafi 1, pika 1.3 të LPP-së dhe si e tillë paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit, sepse i përmbajnë elementet siç kërkohet me paragrafin 3 të këtij neni, i cili shprehimisht përcakton se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, si dhe është në pajtim me nenin 37 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit të bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Prandaj, bazuar në këto arsye, kjo gjykatë vlerëson se dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu që përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së dhe në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë analizoi pretendimet e debitorit por vlerëson se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë konkrete në mbështetje të tyre siç parashihet me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, ashtu që të njëjtat i refuzoi si të pabazuara.

Debitori në ankesë nuk ka kontestuar në asnjë rast e-mailin e datës 16.05.2019 me të cilin ka konfirmuar pagesën ndaj kreditorit, për faturën përmbaremore, prandaj pretendimet ankimore të debitorit kjo gjykatë i vlerësoi si të pabazuara dhe të pa argumentuara.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1318/2023 me datë 22.04.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha